



Buletin Informativ

Aktivitetet e muajit Dhjetor 2018

Aktivitetet kryesore:

- Zhvillohet trajnimi i grupit të 1-rë të NSPK-ve të DVP Durrës.
- Forumi online i NSPK-për edukimin dhe punën me të rinjtë intensifikon punën.
- Mbahet mbledhja VI-të e Grupit të Përbashkët të Punës.
- 16 Ditë të aktivizmit kundër DhbGJ.
- Shoqata Stop drogës, Hiv/Aids organizon takime në qytetin e Krumës.

Zhvillohet trajnimi i grupit të 1-rë të NSPK-ve të DVP Durrës.



Gjatë datave 17-20 Dhjetor 2018 u zhvillua në ambientet e shtëpisë së pushimit Durrës, trajnimi i grupit të parë prej 25 NSPK të DVP Durrës (komisariatit të Durrësit, Krujës, Shijakut, si dhe të postës së policisë Plazh dhe Fushe Kruje) me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për policimin në komunitet. Ekspertët e programit SCPA në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë trajtuan, temat teorike mbi Policimin në Komunitet të tilla si Policimi në Komunitet si filozofi, sistemi dhe elementet e Policimit në Komunitet etj. Një hapësirë e konsiderueshme iu dedikua trajtimit në mënyre praktike të rolit, detyrave dhe përgjegjësi të NSPK-së, si dhe parandalimit në rendin publik, veprimet pro-aktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimit me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj. Me fillimin e këtyre grup trajnimeve, Programi SCPA, çel fazën e trajnimeve të NSPK-ve për 10 DVP-të e tjera, përveç DVP-ve pilot Kukës, dhe Elbasan, ku rritet pesha specifike e trajnuesve të Akademisë së Sigurisë, të certifikuar më parë nga SCPA. Pjesëmarrësit e vlerësuan angazhimin, dhe shkëmbimin e eksperiencës si dhe metodologjinë e përdorur dhe shprehen dëshirën për të pasur trajnime të tilla edhe në të ardhmen sidomos për sa i përket menaxhimit të konflikteve.

Forum online i NSPK-për edukimin dhe punën me të rinjtë intensifikon punën.

Gjate muajit dhjetor, NSPK-të për edukimin dhe punën me të rinjtë kanë vazhduar zbatimin e planit të leksioneve në shkolla me ritme shume të larta. Krahas punës në terren, NSPK-të kanë qenë shume aktivë dhe në forumin online të krijuar posaçërisht për të pasqyruar punën e tyre si dhe për të shkëmbyer eksperiencat mes njëri tjetrit. Gjatë monitorimit të forumit nga SCPA rezultoi se deri tani janë anëtarësuar në forum më tepër se 60 % e grupit prej 52 NSPK-ve të trajnuar gjatë muajit nëntor 2018 nga programi SCPA. Janë postuar 135 foto të aktiviteteve në të 12 DVP-të, si dhe ka pasur diskutime në chat-room. Gjatë kësaj periudhe, janë spikatur NSPK-të e Tiranës, Elbasanit, Kukësit, Hasit, Fierit, Sarandës, Durrësit, Lezhës etj.



www.cp-project.al
info@cp-project.al

Mbledhja VI e Grupit të Përbashkët të Punës



Me datë 11 dhjetor 2018, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme u mbajt mbledhja e gjashtë e Grupit të Përbashkët të Punës (GPP) mes ekipit të Programit dhe drejtues në Drejtorinë e Përgjithshme.

Çështjet kryesore që u përfshinë në këtë takim ishin aktivitetet e zhvilluara nga programi në bashkëpunim me policinë si trajnimi i punonjësve të sektorit të analizës së DVP Kukës dhe Elbasan, trajnimi instruktorëve të Akademisë së Sigurisë që vijojnë me

trajnimin e të gjithë SPZ-ve të Shqipërisë, përmirësimet në infrastrukturë me rikonstrukcionin e ZSHQ- së Hasit, trajnimi i 52 SPZ-ve që do rrisin kulturën për sigurinë tek të rinjtë, mbështetja e policisë për fushatën e ndërgjegjësimit kundër dhunës në familje etj. Për sa i përket punës së bërë nga grant-marrësit u be një përmbledhje e aktiviteteve të tyre të shpjeguara edhe me foto.



Gjithashtu u bë prezantimi i gjetjeve të Sistemit të Matjes së Sigurisë në Komunitet për DVP Elbasan dhe atë Kukës, i cili do të përdoret për hartimin e strategjive dhe planeve të punës për vitin 2019 në këto dy DVP.

Aktivite ndërgjegjësuere për Dhunën në Familje dhe Dhunën me Bazë Gjinore

16 Ditë të Aktivizmit kundër DHBGJ.



Në mbështetje të fushatës kombëtare të 16 Ditëve të aktivizmit kundër Dhunës me bazë Gjinore (DhbGj), prej datës 26 Nëntor deri në datën 10 Dhjetor 2018, janë organizuar aktivitete ndërgjegjësimi përmes ngritjes së këndeve informuese me pjesëmarrjen e nxënësve të 31 shkollave të mesme në 7 qarqe, Tiranë, Durrës, Elbasan, Kukës, Fier, Shkodër dhe Gjirokastrë.



Fushata u realizua në bashkëpunim me DVP-të në qarqe dhe me angazhimin e 11 Organizatave të Shoqërisë Civile, zbatuese të projekteve të Skemës së Grantëve.

Qëllimi i fushatës ishte rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave si dhe nxitjen e ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta për parandalimin e këtij fenomeni.

Fushata u mbështet me materiale të ndryshme promocionale si postera, banera, fletepalosje, stilolapsa me logo etj.

Aktivite në kuadër të skemës së granteve.

Shoqata "Stop drogës, Hiv/Aids" organizon takime në qytetin e Krumës



Shoqata "Stop drogës, Hiv/Aids" mbështetur nga skema e granteve e programit SCPA ka qenë shumë aktive në qarkun e Kukësit. Gjatë muajit dhjetor ajo ka zhvilluar aktivitete në rrethin e Hasit. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me përfaqësues nga Drejtoria Arsimore, Drejtoria e Shëndetit Publik, Bashkia Has, Komisariati i Hasit dhe me pjesëmarrjen e numri të madh nxënësish, u organizua me datën 11 Dhjetor 2018, në ambientet e Gjimnazit "Skenderbeu" Krumë, si shkollë qendër komunitare, një workshop/seminar mbi temat e parandalimit të përdorimit të drogës, substancave ilegale dhe të alkoolit por

edhe të nevojës së ndërtimit të partneriteteve me Policinë e Shtetit.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin dhe Drejtuesi i PMT z. Ansi Shundi, si dhe z. Pontus Förberg, Drejtor i Projektit, FCG Suedi. Pas seminarit, u organizua një takim i ngushtë me drejtuesit nga institucionet e lart-përmendura ku u theksua nevoja për shtimin e aktiviteteve të tilla, pjesëmarrja aktive të nxënësve si dhe domosdoshmëria për të krijuar një qendër informimi dhe këshillimi për të rinjtë e qytetit të Hasit.



Programi "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri-SCPA" uron të gjithë bashkëpunëtorët gëzuar festat e fund vitit dhe suksese të mëtejshme për vitin 2018.

SCPA
Suedi Sverige
"Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri"
JU URON
Gëzuar
Krishtlindjet
dhe **Vitin e Ri 2019**